

**INFORMACION I  
RËNDËSISHËM  
MBI SIGURINË  
NDAJ ZJARRIT SI  
DHE SIGURIA NË  
BANESËN TËNDE**



Viktig information om brandskyddet och säkerheten i din bostad

Språk: Albanska



# RREZIQUET E ZJARRIT NË SHTËPI

- Çdo vit ndodhin mijëra shpërthime zjarri në banesa, të cilat janë aq serioze për të cilat alarmohet Shërbimi i shpëtimit. 100 njerëz e humbin jetën dhe shkaktohen dëmtime të cilat arrijnë shumën 1,1 miliard korona.
- Zjarre më të vogla dhe ndodhi të rrezikshme po aq shumë. Shkak i zakonshëm i zjarrit në shtëpitë tona është nga defekti elektrik si dhe nga nxehja e tepruar e llojeve të ndryshme. Djegie e televizorit, makinës për larjen e enëve si dhe makinës për tharjen e robave, duke u shkaktuar nga defekti elektrik në to. Mos lë kurrë banesën tënde me ndonjë makinë të lëshuar.



- Qirinjtë harruar ndezur shkaktojnë zjarre të shumta të panevojshme.
- Katër nga pesë zjarret shkaktohen nga faktori njeri.



- Zjarri në tenxhere ose në filtere mbi stufë, e ashtu quajtur zierje e tharë shkaktojnë si edhe zjarret tjera, një tym helmues. Zjarri përhapet lehtë në një kanal të yndyrshëm të avullit dhe në tërë banesën ose shtëpinë. Pirja e duhanit shkaktojnë shumë zjarre të rënda, dhe nga kjo pasojë lëndohen dhe vdesin shumë njerëz.

## PARANDALO ZJARRIN

- Një paralajmërues (alarm) zjarri është pajisja më e rëndësishme për mbrojtje ndaj zjarrit në banesën tënde. Një alarm zjarri heton shumë shpejtë tymin dhe atëherë bie alarmi më një sinjal të fort. Kontrollon rregullisht baterinë e alarmit të zjarrit. Kij parasysh se funksioni i alarmit të zjarrit dobësohet pas dhjetë vitesh. Ndërro atëherë alarmin.
- Pronari i ndërtesës ka përgjegjësinë që të ketë një alarm zjarri në banesë. Banori ka përgjegjësinë që alarmi i zjarrit të funksionoj.
- Mos harro alarmin e zjarrit në shtëpizën verore ose në kampshtëpizë. Ekziston edhe alarm i veçantë zjarri udhëtari, të cilin mund ta marrësh me vete në hotel.
- Merr masa të menjëhershme kur gypat ndriçues të neonit vezullojnë. Çdo vit shkaktohen me qindra shpërthime zjarri nga gypat defekt të neonit.
- Në shumtën e këtyre rasteve, rreth 100 zjarre vdekjeprurëse që ndodhin për çdo vit në banesa, nuk ka pasur alarm zjarri në funksion.

## KËSHILLA TË TJERA TË MIRA PËR T' I IKUR ZJARRIT

- Kij kujdes me qirinjtë. Shkruaj një copë letër kujtese me mbishkrimin "mos harro qirinjtë" dhe vë në anën e brendshme të derës së jashtme.
- Bërë shprehi që ta mbyllësh televizorin me sustën e kyçjes/shkyçjes të aparatit. Mos e mba televizorin në vitrinë ose në ndonjë vend tjetër ku mund të grumbullohet pluhur dhe të bëhet ngrohtë.
- Heq nga priza pas përdorimit të automatit të kafes dhe të rreshkësit të bukës.
- Kij kujdes që filtri dhe ventilatori i kuzhinës mos të jenë me yndyrë.



# MËSOHU TË NDËRHYSH

Të gjitha zjarret janë në fillim zjarre të vogla. Prandaj është me rëndësi ta dish se si duhet vepruar drejtpërdrejt, nëse shpërthen zjarri. Rregulli themelor është SHPËTO-PARALAJMËRO-ALARMO përmes 112. SHUAJ.

● ZJARR NË TENXHERE. Zhvendos tenxheren nga pllaka e zierjes. Shuaj zjarrin me një kapak. Mos përdor kurrë ujë nëse ka shpërthyer zjarri në margarinë, vaj ose tjetër yndyrë.



● ZJARR NË TV. Fillon zakonisht me qitje tymi nga televizori. E heq nga priza elektrike kontaktin, hidh ujë mbi të, dhe mundohu ta nxjerrësh aparatin jashtë (p.sh. në ballkon).

● ZJARR TJETËR. Nëse zjarri është i vogël dhe ti ke pajisje për ta shuar zjarrin, atëherë i afrosh zjarrin me pozicion të ulët dhe spërkat në vatrën e zjarrit. Ec këmbadoras nën tymin.

● NËSE NUK MUND TA SHUASH VET ZJARRIN: Mbyll derën e hapësirës ku ka shpërthyer zjarri, alarmo Shërbimin e shpëtimit, dhe dil nga banesa. Vini re! Mbyll derën e banesës!

● Mëso kuptimin e fjalëve POSHTË NËN TYM dhe MBYLLE ZJARRIN.



# INFORMACION I RËNDËSISHËM

Nëse shpërthen zjarri diku gjetiu në ndërtesë, jo në banesën tënde, duhet të kesh parasysh këtë:

● Mos dil kurrë në shkallë nëse ka tym atje. Tymi shtohet me shpejtësinë e rrufesë, dhe mund të jetë vdekjeprurëse.

● Rri edhe me tutje në banesë, aty je më i/e sigurt.

● Dera jote e banesës e përballon zjarrin 30 minuta.

● Nëse je i/e shqetësuar, telefono 112. Nëse Shërbimi i shpëtimit ka ardhur aty, vendos lidhje me ta përmes dritares ose ballkonit.

● Prit në udhëzimet e Shërbimit të shpëtimit.



# ALARMO

Kur të telefonosh 112 lidhesh me Centralin e SOS-it. Përgjigju në pyetjet e operatorit të SOS-it. Kështu merr ndihmën më të mirë dhe më të shpejtë. Për derisa operatori të pyet ty, fillon një operacion tjetër; i alarmimit të stacionit të zjarrfikësve më të afërt.

● Ji i/e gatshëm të marrësh udhëzimet e operatorit të SOS-it.



● Takoj ata dhe trego ku ka nevojë për ndihmë.

● Telefono me dëshirë SOS 112 përsëri, nëse ke të dhëna kompletese.

● Ji i gatshëm se një zjarr ose një fatkeqësi mund të ndodhë në çdo kohë. Mendo mirë se si duhet të veprësh, nëse ti ke nevojë t'i telefonosh SOS-it 112.

# LISTA E VERIFIKIMIT MBROJTJA NDAJ ZJARRIT NË BANESË



## PLOTËSO DHE KONTROLLO MBROJTJEN NDAJ ZJARRIT NË BANESËN TËNDE

### Lista e verifikimit për një siguri të shtuar për ty dhe fqinjët e tu

#### Ndjek këtë listë dhe kontrollo mbrojtjen ndaj zjarrit në banesën tënde dhe në ndërtesë.

- Banesa duhet të jetë e pajisur me së paku një paralajmërues zjarri (alarm)
- Kontrollo funksionin e paralajmëruesit të zjarrit. Është përgjegjësia jote që paralajmëruesi i zjarrit të funksionoj.
- Kontrollo pajisjet elektrike në banesë. Kablo të zënë pisk. Labërgjim/boshllëk në priza.
- Merr masa ndaj gypave ndriçues të neonit të cilët vezullojnë. Defektet elektrike janë ato që zakonisht shkaktojnë zjarre.
- Mos vendos qirinj mbi televizor.
- Televizori duhet të qëndroj i lirë. Shkyçe televizorin më sustën e aparatit.
- Ruaj shkrepëset që mos të jenë të kapshme për fëmijët.
- E heq kontaktin nga priza, të automatit të kafes dhe të meshkësit të bukës.
- Mos ruaj lëndë të rrezikshme që lehtë i kap zjarri në depot ë bodrumit ose nën çati.
- Kij kujdes që filtri dhe ventilatori i kuzhinës mos të jenë me yndyrë.
- Kij kujdes që bërrilok dhe gazeta të mos grumbullohen pa nevojë në shkallë, në bodrum dhe nën çati.
- Derëzat e bërrilokut në shkallë duhet gjithmonë të jenë të mbyllura.
- Kontejnerët në oborr? Distanca e sigurisë nga ndërtesa është 4 metra për kontejner të mbuluar dhe 6 metra për kontejner të hapur.
- Dyert e bodrumit dhe të nën çatisë duhet gjithmonë të jenë të mbyllura.
- Banesa është mirë të jetë e pajisur, me së paku një zjar-rshues dore (rekomandohet 6 kg pluhur-ABC).
- Kontakto në rend të parë pronarin e ndërtesës nëse mendon se ka mungesa nga aspekti i mbrojtjes ndaj zjarrit. Nëse ke pyetje, je gjithmonë i/e mirë se ardhur t'i telefono-nosh Shërbimit të shpëtimit në komunën tënde.

### Nëse ka filluar diçka të digjet

Shpëto, paralajmëro, alarmo, shuaj, janë këto katër fjalë të rënd sishme t'i mbash mend kur shpërthen zjarri.

- Shpëto njerëzit të cilët janë në rrezik, paralajmëro njerëzit për rreth dhe alarmo Shërbimin e shpëtimit përmes 112.
- Mundohu ta shuash zjarrin nëse ke zjarrshuese ose zorrë, por mos rreziko diçka pa nevojë.
- Nëse dhoma mbushet me tym - ec këmbadoras nën tym. Afër dyshemesë ka oksigjen.
- Mbyll derën e hapësirës ku ka shpërthyer zjarri.
- Rri në banesën tënde, nëse ka shpërthyer zjarri diku gjetiu në ndërtesë. Mos dil në shkallë ku ka tym. Nëse ke nevojë për ndihmë – telefono 112.

### Ia kanë futur zjarrin

Shumë zjarre që shpërthejnë, ia ka futur dikush zjarrin. Çdo vit shpërthejnë mbi 10 000 zjarre, që ia ka futur dikush zjarrin. Na ndihmoni kundër fenomenit të futjes së zjarrit.

- Ji vigjilent ndaj të paautorizuarve/të cilët nuk duhet të sillen andej.
- Mos ruaj kurrë dënga të gazetave, kartonë ose të ngjashme në bodrum apo në shkallë.
- Mbjaj dyert e bodrumit dhe të nën çatisë të mbyllura.
- Kij kujdes që derëzat e bërrilokut në shkallë të jenë të mbyllura.
- Nëse ke informacion të japësh me rastin e një shpërthimi zjarri, atëherë kontakto policinë.